

URDHËR
Nr. 97, datë 7.5.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të ligjit nr. 111/2015, “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë për miratimin e Programit Zhvillimor të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për vitin 2024, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku